

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POSTA E KOSOVËS SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **vetak-23-134-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me 7 vetura të transportit të dergesave postare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Mercom Company SH.P.K.
NUI	810298548
Adresa	20/3 FAZLI GRAJÇEVCI
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	ROBERT GEGAJ
Adresa elektronike	robert.gegaj@mercomcompany.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.04.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me 7 vetura të transportit të dergesave postare

Njoftimi për kontrate : 19.01.2023

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve 06.03.2023 ora 14:00

Procesverbali i hapjes se tenderëve 06.06.2023

Letër standarde e kërkesës për sqarim 1: 13.03.2023 (emaili i datës: 16.03.2023)

Përgjigje 1 nga Mercom Company: 16.03.2023

Letër standarde e kërkesës për sqarim 2: 21.03.2023 (email i datës: 23.03.2023)

Përgjigje 2 nga Mercom Company: 23.03.2023

Letër standarde e kërkesës për sqarim 3: 27.03.2023

Përgjigje 3 nga Mercom Company: 27.03.2023

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar: 14.04.2023

Njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues: 14.04.2023

Kërkese për qasje ne dokumentet zyrtare 17.04.2023

Qasja ne dokumentet zyrtare ne zyrat e Posta e Kosova Sh.A. 18.04.2023

Kërkesa për Rishqyrtim 19.04.2023

Vendimi nga AK ne Kërkesën për Rishqyrtim 20.04.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Sipas procesverbalit te hapjes kane qene 5 ofertues si vijon:

Nr.

Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik Vlera totale e ofertës nga OE

1. Mercom Company Shpk 214,760.00 €

2. Auto Mita Shpk 237,930.00 €

3. Auto Shtepia Siqani shpk 239,700.00 €

4. Delfin Auto shpk 244,930.00 €

5. ‘Auto Kacandolli’ Shpk 264,600.00 €

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne si OE me date 19.04.2023 kemi parashtruar Kërkesen për Rishqyrtim pranë AK-se duke cekur të gjitha shkeljet që AK ka bërë në këto aktivitete të prokurimit dhe të njejtat po i bashkangjesim në këtë ankese.

AK me date 20.04.2023 ka marrë vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim duke mos marrë parasysh fare asnjë nga faktet dhe argumentet që ne i kemi parashtruar në kërkesën për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1. Qellimi

Neni 7. Barazia në trajtim / jo diskriminim

Neni 28. Specifikimet teknike (paragrafi 6)

Neni 59. Ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderëve

Neni 60. Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62. Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69. Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke ju referuar kërkesës nga Posta e Kosovës për **Furnizim me 7 vetura të transportit të dërgesave postare**”, Mercom Company ka ofertuar duke i respektuar të gjitha kërkesat në FTD të dosjes së tenderit.

Mercom Company ka ofertuar me çmimin me të lirë duke kursyer buxhetin e planifikuar të AK në vlerë prej 51,240.00 € apo 7,320.00 € për një automjet me lirë së buxheti i planifikuar.

Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2) një nder tjera ka kërkuar si vijon:

2.Katalog nga prodhuesi si dhe katalog për pajisjet shtesë që ju montohen	2.Të dorzohet katalogu i veturave nga prodhuesi me të cilat oferton OE si dhe katalog për pajisjet shtesë që ju montohen.
---	---

Në kemi plotësuar kërkesën 9.1 & 9.2 të DT duke dorëzuar dokumentet në vijim:

- Katalogun e prodhuesit
- Ofertën teknik (duke specifikuar modelin, dhe të gjitha specifikat teknike)
- Deklaratën mbi plotësimin e specifikave teknike (3.1)
- Nënshkrimin dhe vulosjen (konfirmimin) e Aneks 1 të specifikat teknike

Me datë 13.03.2023 AK **nuk** ka publikuar në eprokurimi *Letër standarde e kërkesës për sqarim dhe i njëjti publikim nuk është realizuar në platformën eprokurimi, pastaj AK ka dërguar email me datën 16.03.2023 me kërkesën që katalogu të përkthehet në gjuhën zyrtare (mundësisht në gjuhën shqipe). **Ne kemi dorëzuar në platformën eprokurimi katalogun në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze me datë 16.03.2023. Dëshmi dokumentin i dorëzuar në eprokurim me datën 17.03.2023 ([Peugeot Boxer - Katalogu.pdf](#) dhe [Boxer Catalogue.pdf](#))***

Edhe pse në kemi dërguar Katalogun, Ofertën teknike, Deklaratën, Nënshkrimin dhe vulosjen e Aneks 1 (të gjithë dokumentet e lartcekur mund të gjenden në ofertën e dorëzuar në eprokurimi), AK kërkon sqarime shtesë *Letër standarde e kërkesës për sqarim 2: 21.03.2023 (email i datës: 23.03.2023), kjo kërkesë e AK edhe pse jashtë kërkesës fillestare në FTD në si OE i jemi përgjigjur duke konfirmuar se automjeti me të cilin ofertojmë i plotëson specifikat teknike të kërkuara në aneks 1 të DT, gjithashtu kemi njoftuar AK se prodhuesi nuk prodhon katalog për secilin model veç e veç, por vetëm katalog të përgjithshëm. Dëshmi dokumentin i dorëzuar në eprokurim me datën 23.03.2023 ([Sqarim nga MERCOM COMPANY për Posta e Kosoves - 23.03.pdf](#))*

Duke e parë që AK me çdo kusht mundohet të gjejë arsye të na eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit, edhe pse kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kemi bërë sqarim se automjeti me të cilin kemi ofertuar i plotëson specifikat teknike në aneks 1 të DT, AK kërkon sqarim shtesë me datë 27.03.2023 ku kërkon shkresë apo deklaratë nga prodhuesi që automjeti i ofertuar nga MERCOM COMPANY i plotëson specifikat teknike të kërkuara në Aneks 1 të DT si dhe konfirmim se prodhuesi nuk lëshon katalog veç e veç. **Ne kemi dorëzuar deklaratën nga prodhuesi duke konfirmuar se automjeti i ofertuar i plotëson specifikat teknike të kërkuara në DT, si dhe prodhuesi nuk lëshon katalog për secilin version të një modelin por vetëm një katalog gjeneral.** *Dëshmi dokumentin i dorëzuar në eprokurim me datën 27.03.2023* ([Statement for Post of Kosovo.pdf](#))

Pas të gjithë konfirmimeve të lartcekura, AK nuk merr parasysh asnjë nga ta dhe ka vepruar jo drejtë duke u thirrur në **UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK** dhe duke mos trajtuar drejtë specifikat teknike dorëzuar dhe janë të faktuara në platformën eprokurimi, e njëkohësisht në këtë rast ka shkelur piken 6 të nenin 28 të LPP

Me datë 14.04.2023 kemi pranuar njoftimin për vendim nga AK.

Pretendimi i AK që ne nuk kemi dorëzuar specifikacioni teknik nuk qëndron në asnjë moment sepse ky dokument mund të gjendet në dosjen e dozuar në eprokurimi.

Vlenë të theksojmë se pas qasjes në dokumentet është parë se gjatë *Letër standarde e kërkesës për sqarim* të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë dhënë përgjigjen e njëjtë sa i përket katalogut, pra asnjë prodhues nuk ofron katalog veç e veç për secilin version të një modeli, por vetëm një katalog gjeneral për një model.

Komisioni vlerësues në raport ka cekur se ka hulumtuar në internet dhe katalogët e njëjtë figurojnë edhe në internet, gjithashtu ka kërkuar deklaratë nga prodhuesi apo distributori se automjeti me të cilin oferton OE i plotëson specifikat teknike të kërkuara në Aneks 1 të dosjes së tenderit. Në si OE kemi ofruar deklaratën në fjale me kërkesë nga AK, por edhe kjo deklaratë nuk është marr parasysh.

Gjithashtu vlen të theksojmë se në pyetjen e AK drejtuar KRPP kemi vërejtur se AK nuk ka dhënë informata të sakta në lidhje me aktivitetin e prokurimit pasi që në FTD pika 9.1 & 9.2 është kërkuar:

”Katalog nga prodhuesi si dhe katalog për pajisjet shtesë që ju montohen”, kurse AK gjatë përpilimit të pyetjes ka shkruar se AK ka kërkuar si vijon:

”Katalog nga prodhuesi si dhe katalog për pajisjet shtesë” pra nuk është përshkruar ajo që është kërkuar nga AK në dosjen e tenderit.

Është vërejtur se AK nuk e ka përshkruar aktivitetin e prokurimit se për çfarë behet fjalë pasi që ne pyetjen drejtuar KRPP është cekur si aktivitet që ka të bëjë me furnizim me pajisje, kurse ky aktivitet ka të bëjnë me furnizim me automjete dhe jo pajisje.

Duke iu referuar përgjigjes se KRPP, kemi vërejtur se në asnjë mënyre KRPP nuk kërkon që të shkohet drejt anulimit të aktivitetit por ceket shume qartë që të kërkohen sqarime shpesh për aktivitetin e prokurimit dhe të veprohet në bazë të përgjigjeve të OE.

Edhe njëherë konfirmojmë se kemi dorëzuar

- Katalogun e prodhuesit
- Ofertën teknik (duke specifikuar modelin, dhe të gjitha specifikat teknike)
- Deklaratën mbi plotësimin e specifikave teknike (3.1)
- Nënshkrimin dhe vulosjen (konfirmimin) e Aneks 1 të specifikat teknike
- Sqarimin nga Mercom Company
- Deklaratën nga distributori se automjeti i ofruar i plotëson specifikat teknike

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Fitimi i humbur

Dëmtimi i imazhit të kompanisë sonë.

Vështirësitë për të mbijetuar të drejtën e përfituesit kur është me i liri i përgjegjshëm sipas kërkesës në DT dhe plotëson të gjitha kriteret dhe nuk shpërblehemi me kontrate publike, për të cilin buxhet të Republikës së Kosovës edhe në si OE jemi kontribut dhënës (taksapagues), dhe kemi të drejtë atëherë kur i plotësojmë kriteret të shpërblehemi me dhënie të kantatës e sidomos në këtë rast që jemi kompanija me lire e përgjegjshme.

Propozojmë: Që tenderi të KTHEHET NE RIVLERESIM DHE TE RIVLERSOHET duke pasur parasysh të gjitha shkeljet e lartcekura nga AK-ja.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*